

Përfshirja Sociale e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar në Kosovë

Termet e Referencës

Ekspert lokal për zhvillimin e një Plani Avokues për fëmijë me aftësi të kufizuara në Kosovë dhe aftësimin e përfaqësuesve relevant për implementimin e tij.

| | |
|-------------------------------------|--|
| Titulli | Ekspert lokal për zhvillimin e një Plani Avokues për fëmijë me aftësi të kufizuara në Kosovë dhe aftësimin e përfaqësuesve relevant për implementimin e tij. |
| Lloji i konsulencës | Konsulencë individuale |
| Lokacioni | Prishtinë, Kosovë |
| Periudha e angazhimit | 30 Janar 2018 – 15 Mars 2018 |
| Data e fillimit (kur pritët) | 30 Janar 2018 |
| Të raportohet tek | HANDIKOS - KOSOVË |

HANDIKOS

HandiKOS, është organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1983, që përfaqëson dhe përkrah personat me aftësi të kufizuar në Kosovë duke avokuar, lobuar dhe duke ofruar shërbime përmes rrjetit të shtrirë në të gjithë Kosovën për të arritur të drejta të barabarta, një jetë të pavarur dhe të dinjitetshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

HandiKOS ka një shtrirje të gjerë në të gjithë Kosovën përmes qendrave të rehabilitimit të bazuar në bashkësi në **14 komuna dhe 12 zyre lokale**, në të cilat ka pilotuar dhe ofruar një sërë modelesh të shërbimeve sociale të bazuara në bashkësi.

HandiKOS në strategjinë e saj 5 vjeçare (2018-2022) ka përcaktuar këto objektiva strategjike: *pjesëmarrja; punësimi; edukimi; mirëqenia sociale; shëndeti; dhe zhvillimi organizativ.*

HANDIKOS është licencuar për shërbime sociale dhe familjare, përkatësisht për shërbime për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara, posedon edhe staf të licencuar, Hapësira të mjaftueshme dhe të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, pajisje rehabilituese dhe didaktike për ofrim të shërbimeve, si dhe automjete të mjaftueshme dhe të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.

Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Në Kosovë, në bazë të ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo Qeveritare, janë të regjistruara rreth 50 OJQ të cilat punojnë në fusha të ndryshme për personat me aftësi të kufizuara. Nga ky numër, konsiderohet që OJQ aktive mund të jenë rreth 25 të tilla, që punojnë në përmbushjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuar.

Duhet përmendur që Kosova ballafaqohet me mungesë të të dhënave për fëmijë me aftësi të kufizuar, llojet e aftësisë së kufizuar, prevalencën dhe shtrirjen e saj.

Përkundër kësaj situata, një numër i konsiderueshëm i organizatave të personave me aftësi të kufizuar, punojnë në realizimi ne të drejtave të tyre duke avokuar dhe ofruar shërbime sociale.

Për arritjen e përmbushjes së plotë të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, organizatat e personave me aftësi të kufizuar bashkëpunojnë ngushtë ne adresimin e çështjeve relevante me fëmijët me aftësi të kufizuar drejtë institucioneve vendore, si ato qendrore po ashtu edhe ato lokale.

Projekti *Përfshirja sociale e fëmijëve me aftësi të kufizuar në Kosovë* mbështetur nga zyra e UNICEF në Kosovë dhe implementuar nga HANDIKOS, ka për qëllim mbështetjen dhe fuqizimin e bashkëpunimit në mes organizatave ekzistuese aktive, përmes zhvillimit dhe implementimit të Planit të Përbashkët të Avokimit për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë.

- **Qëllimi i përgjithshëm**

Plani i Përbashkët për Avokim ka për qëllim të përmirësoj situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuar në Kosovë, implementimi i të cilit bëhet përmes Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe FORUMI Kosovar i Aftësisë së Kufizuar.

Ky Plani i Përbashkët për Avokim për fëmijë me aftësi të kufizuar në Kosovë, synon të fuqizoj rrjetin e OPAK në përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar në vend.

Përderisa për arritjen e saj, nga eksperti lokal pritet të:

1. Zhvilloj Planin e Përbashkët Avokues për fëmijët me aftësi të kufizuar;
2. Ofrimi i trajnimit për metodologjinë e nevojshme për implementimin e Planit të Përbashkët Avokues;

Konsulenca është planifikuar të filloj më 30 Janar 2018 dhe të përfundoj me 15 Mars 2018 me një angazhim prej 13 ditë pune, punë kjo e cila do zhvillohet përmes:

1. Mbledhja e të dhënave – fundi i Janarit 2018
2. Draftimi i Planit të Përbashkët për Avokim (punëtori 3 ditore) – Shkurt 2018
3. Finalizimi i Planit të Përbashkët të Avokimit – fillimi i Mars 2018
4. Trajnimi për implementimin e Planit Avokues (punëtori 2 ditore) – Mars 2018

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në versionin shqip në formë elektronike.

Pagesa

Pagesa për marrëveshjen në fjalë do të realizohet përmes tri (3) transaksioneve gjatë ditëve të angazhimit

- 30% të shumës së kontraktuar pas përfundimit të raportit për mbledhjen e të dhënave.
- 40% të shumës së kontraktuar pas finalizimit të Planit të Përbashkët për Avokim.
- 30% të shumës së kontraktuar pas përfundimit të trajnimit për implementimin e Planit Avokues.

Kualifikimi dhe eksperiencia

Eksperti lokal duhet të ketë:

- Diplomë Universitare në shkencë sociale;
- Dëshmi e përvojës së punës në fushën përkatëse (fëmijë, fëmijë me aftësi të kufizuara);
- Dëshmi të përvojës së punës në avokim dhe lobim;
- Të jetë i/e vetëdijshëm/e për politikën dhe strategjitë kombëtare relevante me fëmijët;
- Njohës/e i/e mirë e çështjes së aftësisë së kufizuara në vend;
- I/e aftë në hartimin e Planeve Avokuese;
- Shkathtësi fasilituese në zhvillimin e trajnimit për implementimin e planit;
- Shkathtësi ndër personale dhe të komunikimit;
- Ndjeshmëri ndaj kontekstit dhe situatave të ndryshme me konotacion kulturor;
- Njohuri për parimet e të drejtave të fëmijëve të bazuara në KDF dhe KB;
- Vetëdije dhe ndjeshmëri në aspektin gjinor, si dhe shkathtësi për integrimin e perspektives gjinore në aktivitete dhe punë.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë

- Letër motivimi, dëshmi që ai / ajo është i/e përshtatshme dhe ka njohuri dhe eksperiencë në zhvillimin e Planeve Avokues për të drejta të fëmijëve apo kategorive tjera të cënueshme;

- Curriculum Vitae (CV);
- Vlerësimi i tarifës për aktivitetet e planifikuara me këtë marrëveshje (bazuar në tarifat për ekspertët lokal)

Procedurat e aplikimit dhe përzgjedhja

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në: durim.gashi@handi-kos.org me subjektin *Aplikacioni për Planin e Përbashkët Avokues për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar*. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 26 Janar 2018.

Eksperti lokal do të përzgjidhet në bazë të përvojës në fushën relevante dhe prapavijës akademike.

Vetëm personat në listën e ngushtë do të kontaktohen, nuk ofrohen informata përmes telefonit.

HandiKOS promovon diversitetin në punë. Personat me aftësi të kufizuar, persona nga komunitetet Rom, Ashkali, Egjiptian dhe etnitete të tjera, pjesëtarë të grupeve të marginalizuara në vend, personat me HIV, janë të inkurajuar të aplikojnë.